The Human Rights Advisory Panel
UNMIK HQ, East Wing, 10000 Pristina, Kosovo

VENDIM

Data e vendimit: 16 korrik 2008

Lënda Nr. 02/07

Ranko Vasic

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillimor për të Drejtat e Njeriut i mbledhur më 16 korrik 2008 me këtë përbërje:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Z. Paul LEMMENS
Znj. Snezhana BOTUSHAROVA-DOICHEVA

Z. John RYAN, Zyrtar ekzekutiv

Pas pranimit të ankesës së lartpërmendur, të paraqitur në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, e datës 23 mars 2006, mbi Themelimin e panelit këshillimor për të drejtat e njeriut,

Pas shqyrtimit të bërë, vendos si vijon:

I. FAKTET

1. Pala ankuese kishte punuar në një ndërmarrje shoqërore (NSH) "Poljoprovreda" në Pejë. Në vitin 1999 ai ishte detyruar të largohej nga Kosova dhe është duke jetuar në Serbi si person i zhvendosur.

   Në kohën kur është privatizuar ndërmarrja në korrik 2004 në valën e tretë të privatizimit, ai ishte përjashtuar nga lista e persoanve me të drejtë të përfitimit të pjesës së tij nga fitimet e privatizimit në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 (të ndryshuar me rregulloren UNMIK-ut nr. 2004/45). Ai i është ankuar Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM). Atij i ishte dhënë një afat kohor brenda të cilit ai është dashur ta paraqesë librezën e punës së tij si dëshmi të punësimit të tij në këtë NSH. Pasi ai nuk ka mundur ta bëjë këtë, AKM-ja e ka hedhur poshtë kërkesën e tij.

2. Pala ankuese, bashkë me një grup të personave tjerë të cilët ishin përjashtuar gjithashtu, kanë parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme).

   Me anë të vendimit të datës 14 qershor 2006, Dhoma e Posaçme ka theksuar se pala ankuese nuk ishte përfshirë në listën e të punësuarëve që kanë të drejtë të përfitojnë nga fitimet e privatizimit. Ajo vlerësonte se ai nuk i plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 pasi kishte paraqitur vetëm një kopje të vendimit për marrëdhënien e punës të datës 1992, por nuk e kishte paraqitur librezën e tij të punës ku vërtetohet se ai kishte qenë i punësuar në këtë ndërmarrje gjatë kohës në fjalë.

   Ligji nuk parasheh kurrëfar ankese kundër këtij vendimi.

   Ky vendim duke se i është dhënë në një datë të mëvonshme të papërcaktuar z. M. M., njërit prej të punësuarve të NSH-së, i cili ishte përfaqësuesi i ankesës dhe një grupi të të punësuarve tjerë, i cili ishte përfaqësuesi i tyre gjatë procedurave të kryera përpara Dhomës së Posaçme. Dëshmia për dorëzimin e këtij vendimi, të cilën me kërkesë të këtij Paneli, pala ankuese e ka marrë prej z. M. M., nuk mbante datë as nënshkrim, prandaj nuk paraqet konfirmim të datës së dorëzimit të tij. Vendimi nuk i është dorëzuar palës ankuese.

   Pala ankuese thekson se ai kishte mësuar për vendimin e Dhomës së Posaçme nga njëri prej ish-kolegëve të tij, i cili po ashtu ishte palë ankuese në këto procedura, në një datë të papërcaktuar në janar 2007. Ky kolegë i ka lejuar palës ankuese që të bëjë fotokopjimin e kopjes së tij të vendimit.

II. ANKESAT

3. Pala ankuese pretendon se vendimet e disfavorshme të AKM-së dhe Dhomës së Posaçme në rastin e tij nuk i kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e palës ankuese si një person i zhvendosur pa liri të lëvizjes dhe kësisoji ishin diskriminuese.

4. Sipas palës ankuese, kjo paraqet shkelje të së drejtës së tij për gëzim të qetë të pasurisë së tijë siç garantohet me nenin 1 të Protokolit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) dhe të drejtës së tij që këtë të drejtë ta gëzojë pa qenë i diskriminuar në bazë të nenit 14 të ECHR.

III. SEANCA PARA PANELIT

5. Kërkesa ishte paraqitur më 4 prill 2007 dhe është regjistruar të njejtën datë.

6. Paneli ia ka komunikuar këtë rast PSSP-së më 7 shkurt 2008 duke i dhënë atij mundësinë që në emër të UNMIK-ut të bëjë komentet lidhur me pranueshmërinë dhe meritat në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe Rregullën 30 të Rregullores së Punës të Panelit. PSSP-ja nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi.

I. LIGJI

7. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të meritës, Paneli duhet të vendos nëse duhet ta pranojë ankesën, duke pasur parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

8. Paneli bën të ditur se në pajtim me nenin 3.1, ai mund ta shqyrtojë një çështje vetëm brenda një periudhe kohore prej gjashtë muajve nga data në të cilën është marrë vendimi përfundimtar.

   Qllimi i rregullës së gjashtë muajve është që të promovohet siguria e të drejtës, për të siguruar që rastet të shqyrtohen nga Paneli brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe të mbrohen autoritetet dhe personat tjerë në fjalë që të mos kenë qartësi për një periudhë të gjatë kohore (shih ECtHR, P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 6638/03, vend. 24 gusht 2004). Periudha gjashtë mujore fillon nga vendimi përfundimtar në procesin e shtjerrjes së të gjitha mjeteve ligjore relevante (ECtHR, Paul and Audrey Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar, nr. 46477/99, vend. 7 qershor 2001).

   Në rastet kur pala ankues me ligj ka të drejtë që kopja e vendimit përfundimtar me shkrim t'i dorëzohet sipas detyrës zyrtare, lënda dhe qëllimi i kriterit gjashtë mujor më së miri përmbushet duke e llogaritur periudhën gjashtë mujore prej datës së dorëzimit të vendimit me shkrim (ECtHR, Worm kundër Austrisë, 29 gusht 1997 § 33, Raportet e Aktgjyimeve dhe Aktvendimeve 1997-V, fq. 1547). Por, në rastet kur rregullat procedurale të aplikueshme nuk e parashohin dorëzimin, është e udhës që pikënisje të merret data kur vendimi është bërë pëfundimtar, që do të thotë atëherë kur palët përfundimisht kanë qenë në gjendje të dinë për përmbajtjen e tij (ECtHR, Papachelas kundër Greqisë [GC], nr. 31423/96, 25 mars 1999 § 30, ECHR 1999-II, ECtHR, Seher Karatas kundër Turqisë, nr. 33179/96, 9 korrik 2002 § 27, ECtHR, Karatepe kundër Turqisë, nr. 43924/98, vend. 3 prill 2003).

   Pala ankuese thekson se atij kurrë nuk i është dorëzuar kopja e vendimit të Dhomës së Posaçme. Ai ka merrë vesh për këtë vendim vetëm pasi një koleg i tij, po ashtu palë ankuese në këtë rast, e ka njoftuar atë lidhur me përmbajtjen e vendimit.

   Paneli vlerëson se, pala ankuese me ligj nuk ka të drejtë që t'i dorëzohet kopja e vendimit në fjalë. Më tej, thekson se në rastet kur grupet e të ish-punësuarve të NSH-së janë të përfaqësuar përpara Dhomës së Posaçme nga njëri prej tyre, që zakonisht nuk është jurist, Dhoma e aplikon nenin 138 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Në bazë të kësaj dispozite, në rastet kur një i autorizuar e përfaqëson një grup të personave, ky vendim mund t'i dorëzohet atij ose asaj. Por, Dhoma e Posaçme nuk ka kurrëfar obligimi për ta bërë këtë. Në bazë të ligjit të aplikueshëm, vetë pala ankuese nuk gëzon të drejtë që t'i dorëzohet vendimi. Për më shumë, nuk ka qenë e qartë nëse përfaqësuesi i palpës ankuese ka gëzuar të drejtën që t'i dorëzohet ai vendim apo jo. Në këto rrethana, si dhe duke pasur parasysh paqartësinë lidhur me dorëzimin e vendimit, Paneli mendon se nuk mund të konsiderohet se pala ankuese nuk ka marrë hapa vijues për t'u informuar lidhur me rezultatin e procedurave, përveç diskutimit të kësaj çështjeje me kolegun, i cili e ka njoftuar atë në fund për këtë vendim.

   Ai vlerëson se ankesa nuk mund të shpallet e papranueshme për shkak të mospërmbushjes së afatit gjashtë mujor.

9. Për sa i përket meritave të rastit, pala ankuese thekson se ai nuk ka qenë në gjendje që të kthehet në Kosovë për ta gjetur librezën e tij të punës, prandaj e ka paraqitur kontratën mbi marrëdhënien e punës dhe librezën shëndetësore

të tij, të cilën e kanë pasur vetëm ata që kanë qenë tëpunësuar si dëshmi e marrëdhënies së punës.

Pala ankuese arsyeton se vendimet e AKM-së dhe të Dhomës së Posaçme nuk i kanë marrë parasysh të gjitha faktet përkatëse lidhur me rezultatin e rastit dhe, veçanërisht, rrethanat personale të palës ankuese, i cili si një person i zhvendosur nuk ka mundur të udhëtojë lirisht për t'i siguruar dokumentet e kërkuara.

10. Paneli vlerëson se ankesat në bazë të nenit 1 të Protokolit Nr. 1, nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokolit Nr. 1, ngrisin çështje lidhur me ligjin dhe të faktit përcaktimi i të cilit duhet të varet në shqyrtimin e meritave të ankesës. Prandaj, Paneli konludon se ankesa në dukje nuk është e pabazuar nu suaza të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Paneli nuk sheh ndonjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzërit,

SHPALL SE ANKESA ËSHTË E PRANUESHME.

John Ryan
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues